

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA - SUPREME COURT OF KOSOVO

- **Për:** Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK)
 - **Nga:** Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e Republikës së Kosovës (DHPGJS)
 - **Datë:** 16 tetor 2022
 - **Lënda:** RAPORT NARRATIV PËR PUNËN E DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR PERIUdhËN
01 korrik – 30 shtator 2022
-

Në DHPGJS gjatë tremujorit të tretë kanë qenë të angazhuar 14 gjyqtarë në zgjidhjen e lëndëve, 11 prej tyre në shkallën e parë dhe 3 në shkallën e dytë, gjegjësisht në Kolegjin e Apelit.


Lëndët në punë gjatë tremujorit

Gjithsej në dy shkallët gjyqësore në fillim të tremujorit të tretë të vitit janë trashëguar nga tremujori paraprak 14952 lëndë, janë pranuar edhe 813 lëndë të reja, kështu gjatë tremujorit në punë kanë qenë 15765 lëndë. Prej tyre janë zgjidhur 652 lëndë, kurse kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej 15113 lëndë në dy shkallët gjyqësore.

Në shkallën e parë gjyqësore të trashëguara janë 13923 lëndë, të pranuar gjatë tremujorit janë 467 lëndë, kështu gjatë tremujorit të tretë në punë kanë qenë 14390 lëndë, Prej tyre janë zgjidhur 495 lëndë, kurse kanë mbetur të pa zgjidhura 13895 lëndë të shkallës së parë.

Në shkallën e dytë gjyqësore të trashëguara janë 1029 lëndë, të pranuar gjatë tremujorit janë 346 lëndë, kështu gjatë tremujorit të tretë në punë kanë qenë 1375 lëndë. Prej tyre janë zgjidhur 157 lëndë, kurse kanë mbetur të pa zgjidhura 1218 lëndë të shkallës së dytë.


Në tabelën më poshtë janë paraqitur lëndët e trashëguara (paraprake) në fillim të tremujorit, lëndët e reja të pranuar, lëndët në punë, lëndët e kryera dhe lëndët e mbetura të pakryera në fund të tremujorit.



Efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve në raport me lëndët e reja të pranuar gjatë tremujorit

Shkalla e efikasitetit të lëndëve të kryera në raport me lëndët e reja të pranuar gjatë tremujorit është 80.20 %, ngase janë kryer 652 lëndë ndërsa janë pranuar 813 lëndë të reja.

Shkalla e efikasitetit 80.20%



Krahasimi me tremujorin paraprak

Krahasuar me tremujorin paraprak (prill-qershor) kemi rënje të numrit të lëndëve të kryera dhe të efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve në raportin lëndët e kryera dhe lëndët e reja të pranuar gjatë tremujorit.

Në tremujorin paraprak janë kryer 691 lëndë kurse shkalla e efikasitetit ka qenë 156.33% kurse në këtë tremujor (korrik-shtator) janë kryer 652 lëndë dhe shkalla e efikasitetit është 80.20%.


Faktorët që kanë ndikuar në numrin e lëndëve të kryera dhe efikasitetit janë:

Një gjyqtar është pensionuar, një gjyqtarë ka shkuar në pushim pa pagesë, shumica e gjyqtarëve dhe stafit administrativ kanë shfrytëzuar pushimet vjetore; por edhe numri i lëndëve të reja të pranuar në këtë tremujor është shumë më i lartë se në tremujorin paraprak, në tremujorin paraprak kanë qenë të pranuar 442 lëndë të reja kurse në këtë tremujor janë pranuar 813 lëndë të reja. Gjithashtu edhe zhvendosja e zyrave nga kati i IV i Objektivit A në Objektivin E dhe në katin 0 të Objektivit A gjithashtu ka ndikuar në punën e gjykatës.

Lëndët e zgjidhura sipas natyres ligjore gjatë tremujorit


Në tabelën më poshtë, janë listuar lëndët e zgjidhura gjatë kësaj periudhe, që përfshijnë:

- 152 lëndë - AC - I, Ankesat e kundër vendimeve të Dhomës
- 5 lëndë - AC - II, Ankesat Kundër vendimeve të gjykatave tjera
- 1 lëndë - C - I, Paditë e Privatizimit
- 6 lëndë - C - II, Listat e Punëtorëve
- 29 lëndë - C - III, Paditë Pronësore
- 459 lëndë - C - IV, Paditë e Likuidimit



Publikimi i vendimeve gjatë tremujorit

Gjatë tremujorit është vazhduar me publikimin e vendimeve të Gjykatës, kështu që janë publikuar në Web faqe gjithsej 380 vendime të Dhomës. Prej tyre 284 vendime janë të shkallës së parë gjyqësore kurse 96 janë të shkallës së dytë.



Identifikimi i problemeve dhe propozimi për zgjidhjen e tyre

Problem i vazhdueshëm në DHPGJS është numri i pamjaftueshëm i stafit gjyqësor dhe atij administrativ. Duke patër parasysh numrin e madh të lëndëve dhe numrin e stafit aktual, është shumë e vështirë dhe e pa mundur të zgjidhen lëndët e grumbulluara në një afat të arsyeshëm. Kështu i propozohet KGJK-ës që të ketë në vëmendje mundësin e shtimit të numrit të stafit gjyqësor dhe atij administrativ në DHPGJS si dhe shtimin e hapësirave të punës.

Si problem gjatë tremujorit ka qenë edhe zhvendosja e gjykatës Nga Kati i IV i Objektit A në Objektin E dhe në një pjesë të Katit 0 të Objektit A. Me shumë vështirësi është bërë akomodimi në hapësirat e reja ngase numri i zyrave ka qenë më i vogël në krahasim me numrin e zyrave të më parme. Kështu i propozohet KGJK-ës që të ketë në vëmendje problemin me hapësirat punuese për nevojat e DHPGJS.

Më datën 03 gusht 2022, është mbajtur takimi i Gjyqtarit Mbikëqyrës me gjyqtarë të DHPGJS .

Procesverbali nga takimi dërgohet së bashku me raportin.